

## 1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

### 1.1. Operacionet e tregut të hapur

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë)

DATA	Tërheqje likuiditeti	Injektim likuiditeti
	REPO njëjavore	Blerje me të drejta të plota e bonove të thesarit
06.07.2006	3,375.00	
13.07.2006	4,005.00	
20.07.2006	2,795.00	
27.07.2006	3,130.00	
03.08.2006	2,895.00	
10.08.2006	3,721.00	
17.08.2006	1,425.00	
24.08.2006	3,290.00	
28.08.2006		1,000.00
31.08.2006	4,570.00	
07.09.2006	5,003.00	
14.09.2006	2,840.00	
21.09.2006	2,785.00	
27.09.2006		500.00
28.09.2006	2,745.00	

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2006, sistemi bankar vazhdoi të karakterizohet nga teprica e likuiditetit, terpicë kjo në rënie në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit. Shkak për uljen e tepricës së likuiditetit ishte kryesisht dalja sezonale e *cash-it* në periudhën e verës. Në ndryshim me pjesën e parë të vitit, qeveria filloi rritjen e kërkesës për financim nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë si dhe tërheqjen e një pjese të likuiditetit të investuar në sistemin bankar nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes. Likuiditeti i nevojshëm për maturimin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me qeverinë u sigurua nga sistemi bankar nëpërmjet maturimit të bonove të thesarit në tregun primar, çka pengoi rritjen e financimit të

brendshëm të qeverisë.

Në kushtet e tepricës së likuiditetit Banka e Shqipërisë tërhoqi likuiditet nëpërmjet instrumentit kryesor të tregut (*marrëveshje riblerjeje me maturim javor*). Në bazë javore, Banka e Shqipërisë tërhoqi mesatarisht 3.3 miliardë lekë nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor.


Duke parashikuar rritjen e kërkesës së qeverisë për financim të brendshëm dhe për të stimuluar plotësimin e kësaj kërkesë nëpërmjet sistemit bankar, Banka e Shqipërisë filloi injektimin e likuiditetit nëpërmjet operacioneve të përhershme, blerjes me të drejta të plota të bonove të thesarit. Likuiditeti i injektuar nëpërmjet këtyre operacioneve ishte 1.5 miliardë lekë. Këto operacione janë në kah të kundërt me operacionet e përhershme, të kryera gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit në kushtet e mungesës së kërkesës së qeverisë për likuiditet.

### 1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Në mbështetje të ndërhyrjeve me instrumentet e tregut të hapur, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 616 milionë lekë në krahasim me 307 milionë lekë në tremujorin e kaluar. Në kushtet e tepricës së likuiditetit dhe plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë tremujorit të tretë të vitit 2006.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2006.


Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në nëntëmuajorin e parë të vitit 2006.



## 2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Edhe gjatë tremujorit të tretë të këtij viti Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun e brendshëm valutor, duke blerë valutë në funksion të përmbushjes graduale të objektivit të Rezervës Ndërkombëtare Neto. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë kanë vazhduar të jenë në kahun e blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë. Blerjet e Bankës së Shqipërisë kanë qenë të përqendruara në periudhën korrik - gusht, periudhë që përkon edhe me prurjet e ofertës sezonale të emigrantëve. Gjatë tremujorit të tretë, Banka e Shqipërisë ka blerë nga bankat e nivelit të dytë 9.61 milionë usd, me një kurs mesatar prej 95.68 lekë dhe 28.70 milionë euro me një kurs mesatar prej 122.30 lekë.



### 2.2 Veprime të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i qeverisë shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm, ku pagesat e kryera gjatë tremujorit të tretë, llogariten në 953.27 milionë lekë

Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave llogaritet në 1,857.70 milionë lekë. Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 63.01 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).